

Kronikë nga seanca e 43-të

Shkup, 29.11.2022 – Këshilli i Agjencisë në mbledhjen e djeshme në bazë të konstatimeve nga mbikëqyrja e rregullt programore dhe administrative ka shqiptuar gjashtë masa për vërejtje publike:

SHTR DIBRA TV SHPKNJP Dibër për shkelje të:

Neni 92 paragrafët 1 dhe 3 të LSHMAAV– mostransmetimi i së paku 30% të programit të krijuar fillimisht si vepra audiovizuele maqedonase, as transmetimi i së paku gjysmës së programit minimal ligjor të krijuar fillimisht si vepër audiovizuele maqedonase në periudhën prej orës 07:00. deri në orën 19:00;

Neni 98 paragrafi 1 të LSHMAAV– transmetimi i reklamave që nuk janë të ndara qartë nga pjesët tjera të programit me mjete optike dhe/ose zanore në fillim të bllokut reklamues;

Neni 50 paragrafi 3 të LSHMAAV– dhe neni 19 i Rregullores për Mbrojtjen e të Miturve – seriale artistike të transmetuara pa sinjale përkatëse paralajmëruese para fillimit dhe pa shenjë klasifikimi për kategorinë programore gjatë gjithë kohëzgjatjes;

Neni 51 paragrafi 1 të LSHMAAV– mossigurimi e informacionit që duhet të jetë në dispozicion të përdoruesve dhe

Neni 14 i Ligjit për Media – mospublikimi i të dhënave të shtypura, të cilat transmetuesi është i detyruar t'i transmetojë në një vend të përshtatshëm për çdo përmbajtje të shërbimit programor.

dhe

SHTR TV KANAL FESTA SHPKNJP Kumanovë për shkelje të:

Neni 51 paragrafi 1 LSHMAAV– mossigurimi i informacionit që

duhet të jetë në dispozicion të përdoruesve.